



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 14.04.2015, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për sektorin e energjisë elektrike”
2. Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 7918, datë 13.04.1995 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 1030, datë 23.02.1995, “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekëve të privatizimit)” dhe dekretit nr.1049, datë 27.03.1995 “Për disa plotësime në dekretin nr.1030, datë 23.02.1995 të ndryshuar”.
3. Projektligji “Për caktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës koncesionare/PPP, me objekt ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e rrugës së Arbrit ndërmjet shtetit shqiptar dhe kompanisë kineze “China State Construction Company”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Silva Caka, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Armando Prenga, Pirro Lutaj, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Blendi Klosi, Tom Doshi.

Të ftuar:

Shkëlqim Cani - ministër i Financave

Irena Beqiri – zëvendësministre në Ministrinë e Financave

Entela Çipa - këshilltare për Energjinë në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë

Agim Bregasi - drejtor i Politikave dhe Zhvillimit Elektroenergjetik në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë

Miranda Lila - këshilltare për Marrëdhëniet me Parlamentin në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë

Dardan Malaj - këshilltar për Mediat në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë

Enea Karakaçi – përgjegjës i Sektorit të Legjislacionit në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë

Endrit Ducka - drejtor i Shitjeve të Pronave në Ministrinë e Financave

Ervin Mete – zëvendësministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Ardit Çollaku - këshilltar i Ministrit në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Artur Pilkati - shef sektori në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Eduart Seitaj - sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.

Ana Kekezi – përfaqësuese nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

Redi Berberi - përfaqësues nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

Anjeza Furxhiu – përfaqësuese nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – ...zonja Çipa këshilltare për energjinë, dy përfaqësueset e ministrit që kanë ndjekur projektin dhe debatin në komision.

Mund të fillojmë.

E kemi lënë që në nenin 108 të ketë një ndryshim.

Në nenin 108, pika 1, referenca 32, pika 1 dhe 32 pika 4, të bëhet 32 pika 1 dhe 4, 33 pika 4 të hiqet, 52 pika 4 të hiqet, 90 pika 5 të bëhet 91 pika 5.

Dakord?

Zoti Manja? Dakord.

Ministria? Dakord.

Faleminderit!

Kush është dakord?

Miratohet.

Ecim me nenin 109. “Shfuqizimi i akteve dhe dispozitave transitore”. Shtohet pika 4. “Kryetari dhe komisionerët, të cilët kryejnë këtë funksion në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji duhet ta vazhdojnë ta kryejnë deri në përfundimin e mandatit të tyre”.

Zoti Manja, ky është formulimi? Dakord.

Dakord. Nuk ka vërejtje e sugjerime.

Kush është dakord në tërësi për projektligjin “Për sektorin e energjisë elektrike”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi.

Faleminderit, përfaqësuesve të ministrisë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 14.04.2015, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 7918, datë 13.4.1995 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 1030, datë 23.02.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekëve të privatizimit)” dhe dekretit nr.1049, datë 27.03.1995 “Për disa plotësime në dekretin nr.1030, datë 23.02.1995”, i ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Silva Caka, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Armando Prenga, Pirro Lutaj, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Blendi Klosi, Tom Doshi.

Të ftuar:

Shkëlqim Cani - ministër i Financave

Endrit Ducka - drejtor i Shitjeve të Pronave në Ministrinë e Financave

Ervin Mete – zëvendësministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Ardit Çollaku - këshilltar i Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Artur Pilkati - shef sektori, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Fatmir Xhafaj - Vazhdojmë me projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 7918, datë 13.04.1995 “Për miratimin e ndryshimeve të dekretit nr. 1030, datë 23.02. 1995 Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit, lekëve të privatizimit” dhe dekretit nr. 1049, datë 27.03.1995 “Për disa plotësime në dekretin nr. 1030, datë 23.02.1995”, të ndryshuar”.

(Pauzë)

Duhet të bëj me dije faktin që njëkohësisht këto projekte i shqyrtojnë tri komisione për shkak të faktit që kanë hyrë me procedurë të përshpejtuar dhe janë në seancën e të enjtes për shqyrtim. Kjo është arsyeja që u krijua edhe ky boshllëk, për shkak se zonja zëvendësministre ishte në një komision tjetër, gjithsesi mund të vazhdojmë normalisht.

E pranishme në këtë pikë të rendit të ditës është zonja Irena Beqiri, zëvendësministre e Financave.

Zonja Beqiri, kemi për miratim projektligjin për ndryshimet e dekretit për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit. Është shtyrje afati, po, gjithsesi, shkurt për arsyet qëllimin e sjelljes së iniciativës nga ana juaj.

Irena Beqiri - Qeveria ka vendosur që ta shtyjë afatin deri në fund të vitit 2016. Ju jeni në dijeni, kjo nuk është shtyrja e parë e bonove të thesarit. Aktualisht ato mendohet që do të përdoren kryesisht në procedurën e legalizimit të ndërtimeve informale, në llogaritjen e formulës së privatizimit për marrjen pjesë të punonjësve të ndërmarrjeve shtetërore në privatizim, duke i shkëmbyer ato me aksione dhe në procesin e privatizimit të SME-ve, ku pronari i truallit do ta gëzojë të drejtën e pagesës për objektin apo në privatizimin e objekteve shtetërore të dhëna me qira.

Po ju rikujtoj që ka qenë 74 miliardë emetimi i bonove të thesarit nga të cilat, 51 milionë janë emetuar dhe janë përdorur deri tani vetëm 10 miliardë, pra, janë ende 41 miliardë të papërdorura, kështu që ministria mendoi që përsëri t’i japë një mundësi publikut të ketë mundësi t’i përdorë mbase edhe këtë vit, meqë dhe proceset e legalizimit janë intensifikuar, sidomos ato të ndërtimeve informale.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Qëllimi duket më shumë se pozitiv për qytetarët, për interesin e qytetarëve.

A ka diçka nga këndvështrimi i komisionit tonë?

Po, zonja Caka, ju lutem.

Silva Caka – Faleminderit, zoti kryetar!

Siç e përmendi edhe zonja Beqiri, qëllimi i vetëm në zgjatjen e afatit të përdorimit të bonove të privatizimit është për t'u dhënë mundësi ish- pronarëve të truallit në procesin e privatizimi të pronës shtetërore që gëzojnë të drejtën e blerjes së këtij procesi dhe procesit të legalizimit të ndërtimeve aktuale informale nëpërmjet procedurave të ALUIZNI-t. Në aspektin ligjor edhe procedural projektligji ka respektuar të gjitha kriteret e Kushtetutës dhe të Rregullores së parlamentit, kështu që mbetet vetëm t'u propozoj kolegëve që ta miratojnë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Caka!

Nga kjo pikëpamje edhe unë bashkohem me relatorin. Iniciativa e qeverisë është një iniciativë shumë pozitive për të ndihmuar qytetarët që posedojnë bono privatizimi, për t'i përdorur në procesin e legalizimit dhe kjo duhet përshëndetur nga të gjitha krahët.

Nga pikëpamja kushtetuese dhe ligjore, e tha edhe relatorja, nuk kemi ndonjë pengesë.

A ka pyetje? Nuk ka.

A ka diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord në parim? Faleminderit!

Neni 1. Dakord.

Neni 2. Dakord.

Në tërësi kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet .

Faleminderit!

E mbyllim këtë projektligj këtu.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 14.04.2015, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për caktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës koncesionare/PPP, me objekt ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e rrugës së Arbrit ndërmjet shtetit shqiptar dhe kompanisë kineze “China State Construction Company”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Silva Caka, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Armando Prenga, Pirro Lutaj, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Blendi Klosi, Tom Doshi.

Të ftuar:

Shkëlqim Cani - ministër i Financave

Endrit Ducka - drejtor i Shitjeve të Pronave në Ministrinë e Financave

Ervin Mete – zëvendësministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Ardit Çollaku - këshilltar i Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Artur Pilkati - shef sektori në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Eduart Seitaj - sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.

Ana Kekezi - përfaqësuese nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Redi Berberi – përfaqësues nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

Anjeza Furxhiu - përfaqësuese nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

Fatmir Xhafaj - Vazhdojmë me projektligjin tjetër “Përcaktimi i procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratave koncesionare me objekt ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e rrugës së Arbrit, ndërmjet shtetit shqiptar dhe kompanisë kineze “China State Construction Company””.

Zonja zëvendësministre, besoj se edhe kjo është pozitive. Edhe ne, edhe qeveria jemi të kënaqur që po ndodh kjo gjë.

Një përmbledhje, ju lutem.

Irena Beqiri – Atëherë, e vetmja gjë që ka ky projektligj është përcaktimi i një procedure të veçantë në lidhje me këtë kontratë koncesionare. Kjo kontratë lidhet me një nga kompanitë shtetërore ndërtimore kineze, e cila do ta financojë tërësisht tre vjetët e para këtë ndërtim dhe më vonë i vetmi ndikim që do të ketë në buxhet është që qeveria shqiptare pas ndërtimit, pas tre vjetve, do të vendosë një fond garancie, që, sipas llogaritjeve tona të jetë rreth 26 milionë lekë në buxhet, nëse këto nuk mbledhen nga *todhet*, domethënë nga kompania nga përdorimi i rrugës. Është rrugë shumë interesante, sepse fillon nga Dajti e deri në Dibër, pra, lidh Tiranën me Dibrën. Mendohet që do të jetë një rrugë e cila do t’i hapë zhvillim ekonomik zonës së Veriut të Shqipërisë.

Do të kemi një procedurë të drejtpërdrejtë. Nuk janë si koncesionet e zakonshme sepse ligji i koncesioneve i ka përjashtuar ndërtimet e rrugëve kaq të mëdha. Ky është i vetmi ndryshim.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Relatori, zoti Manja.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Unë, në cilësinë e relatorit të këtij projektligji, për kohëzgjatje jam edhe deputet i qarkut Dibër. Ndërtimi i kësaj rruge ka qenë një nga premtimet elektorale të qeverisë të kësaj maxhorance dhe sot gjej rastin, të falënderoj qeverinë për këtë iniciativë, por edhe secilin prej kolegëve të këtij komisioni që me votën e tyre do të bëhen pjesë e ndërtimit të një rruge të shumëpritur të komunitetit të Dibrës, Matit, Bulqizës. Por kjo rrugë nuk do të lidhë vetëm këto tri zona urbane të qarkut të Dibrës me Tiranën, do të bëjë më në fund, lidhjen e qarkut të Dibrës me Tiranën dhe me portin e Durrësit.

Komisioni ynë e vlerëson këtë projektligj nga pikëpamja kushtetuese dhe ligjore. Ky projektligj është në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe kuadrin legjislativ në fuqi. Ajo që do të theksoja në lidhje me rëndësinë e këtij projektligji është fakti se kompania që ofrohet për ndërtimin e kësaj rruge, është një kompani kineze ndërtimi, e cila renditet në tri kompanitë më

të mëdha në botë dhe e para në sektorin e ndërtimit, sipas klasifikimit të bërë nga revista “The Economist” në vitin 2012.

Institucionet e ngarkuara për zbatimin e këtij projektligji, pra për negocimin, lidhjen e kontratës me kompaninë kineze, do të jenë tri ministri; ajo e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Duke qenë se ky projekt përbën një nga angazhimet thelbësore të kësaj maxhorance dhe të qeverisë në drejtim të përmirësimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore, do t’i ftoja kolegët ta votojmë këtë projektligj, si edhe do të kërkoja që me mirëkuptimin tuaj, edhe pse u kërkuar me procedurë të përsheptuar, të mos humbim kohë me hyrjen në fuqi të këtij ligji. Pra, hyrja në fuqi e këtij ligji të bëhet menjëherë, gjithmonë duke marrë mendimin paraprak edhe të Presidentit të Republikës.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

A ka pyetje? Nuk ka pyetje.

A ka diskutime? Nuk ka diskutime.

Për shkak të konsensusit që ka për qëllimin dobënë e këtij projektligji, kush është dakord në tërësi?

Ju faleminderit!

Kalojmë te diskutimi nën për nën.

Neni 1. Dakord.

Neni 2. Dakord?

Po, zoti Manja, për procedurat e negocimit.

Ulsi Manja – Po kemi rënë dakord për disa ndryshime të karakterit të teknikës legislative, që kanë të bëjnë me titullin e projektligjit, fjalët “kompani kineze” zëvendësojmë me fjalën shoqëri dhe emri i shoqërisë në rastin konkret duhet të jepet i plotë.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Teknikë legislative është. Neni 2 dakord.

Ulsi Manja – Neni 2, zoti kryetar, një sqarim për termin diligjencë që është term, që përdoret si një fjalë ndërkombëtare.

Irena Beqiri - Bëhet fjalë për një term, domethënë një analizë e plotë që konsiston jo vetëm në analizë financiare por edhe analizë fizibiliteti, ligjore, domethënë vlerësim i përgjithshëm, pra në sensin që të vendosë se sa është vlera reale e një aseti të caktuar.

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 2?

Dakord. Faleminderit!

Neni 3. “Nënshkrimi i kontratës”. Dakord.

Neni 4. “Miratimi i kontratës”. Dakord.

Neni 5. Hyrja në fuqi, siç është, sepse nuk mund të bëjmë ndryshime pa një miratim paraprak. Dakord?

Në tërësi kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me konsensus.

Mbledhja e sotme e komisionit mbyllet.

Faleminderit!

MBLEDHJA MBYLLET